



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM
Nr. 9, datë 26.2.2014**

**PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTIT “POLITIKA E MBIKËQYRJES”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja ”c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 58, pika 1, shkronja c, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin “Politika e mbikëqyrjes”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Zëvendësguvernatori i Parë për miratimin e Manualit të Vlerësimit të Rreziqeve. Me hyrjen në fuqi të Manualit të Vlerësimit të Rreziqeve, shfuqizohet Manuali i Inspektimit.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi, nr. 27 datë 14.04.2010 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për dokumentin e politikës operacionale të mbikëqyrjes”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Elvis Çibuku

KRYETARI

Ardian Fullani